



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 156 dt. 27.08.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.08.2015, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërhyrjeve restauruese në suvanë e volumit verior të banesës Sinani (Karagiozi), që ndodhet në lagjen “Dunavat”, Gjirokastrë, projekt i CHwB.
2. Miratimin e ndërhyrjeve restauruese në portën hyrëse dhe çatinë e banesës Xhaxhiu, në lagjen Palorto, Gjirokastrë, projekt i CHwB.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR  
ARTA DOLLANI